



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.55 dt.24.04.1998

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot me dt.24.04.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike e Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit) “Për caktimin e tarifës së pagesës për lejen për të kryer punimet e trajtimit të varreve”, bazuar në Ligjin Nr.7777, dt.23.12.1993 “Për taksat në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”

VENDOSI

1. Të gjithë personat fizikë apo juridikë të pajisur me licensë “Për ndërtim varresh” të paguajnë pranë Ndërmarrjes së Shërbimit Funeral tarifën e përkohëshme prej 500(pesëqind) lekësh për miratimin e ndërtimit të varrit në mjediset e varrezave publike Sharrë dhe Tufinë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit) dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI